

## DYSORËT TERMINOLOGJIKË NË RRAFSHIN E KULTURËS SË GJUHËS DHE NË TERMINOLOGJINË TEKNIKE

### TERMINOLOGICAL DOUBLETS AT THE LEVEL OF LANGUAGE CULTURE AND TECHNICAL TERMINOLOGY

Gani PLLANA<sup>1</sup>, Agron DURO<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Faculty of Mechanical Engineering, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

<sup>2</sup> Corresponding author e-mail: gani.pllana@uni-pr.edu

#### Abstract

Terminological doublets are subjective facts from the point of view of the moment of their appearance, while from the general point of view of language they arise as a necessity of the development and improvement of the language of science and technology. However, as transitory facts of language development, they are not of the same character as the variant norms of the general language. Terminological doublets, in contrast to norms-variants of the language, have a subjective character in terms of their use, but the general causes of their existence are objective.

Their damage to the language of science and technology is small, they exist less in the language. The property of constancy requires the exclusion of inappropriate doublets from the language and the retention of the most appropriate element of the doublets pair. The choice of the most suitable element in the doublets pair or range is directly related to another important property of the terminological norm and culture, the ability of the term to express clearly and precisely, skillfully and without difficulty any scientific and technical concept.

**Keywords:** language culture, terminological doublets, technical terminology.

#### Përmbledhje

Dysorët terminologjike janë fakte subjektive nga pikëpamja e çastit të shfaqjes së tyre, kurse nga pikëpamja e përgjithshme e gjuhës ato lindin si domosdoshmëri e zhvillimit dhe e përsosjes së gjuhës së shkencës e të teknikës. Megjithatë si fakte kalimtare të zhvillimit të gjuhës ato nuk janë të një karakteri me normat variante të gjuhës së përgjithshme. Dysorët terminologjike në dallim nga normat-variante të gjuhës kanë karakter subjektiv nga ana e përdorimit të tyre, por shkaqet e përgjithshme të lindjes së tyre janë objektive.

Dëmi i tyre në gjuhën e shkencës dhe të teknikës është aq më i vogël, sa më pak të ekzistojnë ato në gjuhë. Vetia e qëndrueshmërisë kërkon nxjerrjen jashtë gjuhe të dysorëve të papërshtatshëm dhe lënien në gjuhë të elementit më të përshtatshëm të çiftit dysor. Zgjedhja e elementit më të përshtatshëm në çiftin a vargun dysor dihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vetinë tjetër të rëndësishme të normës dhe të kulturës terminologjike, me aftësinë e termit për të shprehur qartë dhe me përpikëri, në mënyrë të shkathët dhe pa vështirësi çdo koncept shkencor dhe teknik.

**Fjalët çelës:** kultura e gjuhës, dysorët terminologjike, terminologjia teknike.

## 1. Hyrje

Gjuha standarde shqipe është futur prej kohësh në rrugën e përsosjes dhe të kristalizimit të mëtejshëm të saj, duke u ngritur si gjuhë e një kulture të lartë në nivelin e gjuhëve të botës. Si veçori themelore e saj është karakteri i normëzuar dhe i njësuar. Normëzimi dhe njësimi i gjuhës lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kulturën e saj [Shkurtaj 2006:15]. Në gjuhësinë shqiptare, në studimet rreth problemeve të terminologjisë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar vështrimit të leksikut terminologjik në nivel fushash dije të veçanta, të gjera, të ngushta dhe shumë të ngushta. Në përgjithësi këto terminologji janë vështruar në boshtin sinkronik dhe, në raste të veçanta, janë trajtuar edhe në vijën e zhvillimit diakronik. Problemet a anës së historisë së zhvillimit të terminologjive janë kufizuar kryesisht si raste të pjesshme, por jo rrallë janë vështruar edhe si çështje më vete.

## 2. Bazat konceptore të fushave teknike të dijes si sisteme

Historia e zhvillimit të terminologjisë si leksik tërësor në çdo gjuhë, të hershme a të mëvonshme, në nivelin e gjuhës së shkruar tregon se gjendja e arrirë e saj, në një prerje të caktuar kohore është kushtëzuar nga zhvillimi i sistemeve konceptore të fushave përkatëse të dijes, të cilat përbëjnë edhe parakushtin më qenësor të çdo terminologjie si leksik special në krahasim me leksikun e përgjithshëm. Ky konceptim zbulon edhe bazën reale të çdo terminologjie në rrafshin e përmbajtjes, çka bën të mundshme të hidhet dritë mbi rrugën e lindjes, të zhvillimit dhe të formësimit të saj në çdo gjuhë. Kjo shpjegon edhe bashkëlidhjen e brendshme dhe marrëdhëniet e ngushta të sistemeve konceptore të fushave përkatëse të dijes me sistemet e njëjësive gjuhësore (të termave) të këtij leksiku special, të cilat shërbejnë për ruajtjen, tejçimin e informacionit jashtëgjuhësor në procesin e komunikimit ndërmjet njerëzve sidomos në gjuhën e specializuar.

## 3. Gjendja e standardit në terminologji

Si formim leksikor special i veçantë që ndodhet në zhvillim të pandërprerë standardi në terminologjinë teknike përfshihet në standardin e gjuhës, sidomos në leksikun e saj, me një varg veçorish specifike, që lidhen me natyrën e koncepteve dhe të termave. Në mënyrë të veçantë ndryshimet intensive në të kushtëzohen nga përparësitë në terminologji të përmbajtjes para formës, d.m.th. të koncepteve, para termave. Shumë ndryshime në nivel konceptesh e termash pasqyrohen në kundërvënien e termave në raport me konceptet, ku të parat mbeten prapa, kurse të dytat nga ana e vet, duke krijuar probleme serioze në standardin dhe normën terminologjike [Thomaj 2015:24-31]. Zhvillimet në rrafshin e përmbajtjes dhe përzierjet e termave në rrafshin e formës, kanë krijuar në ditët e sotme një gjendje *jo standarde në terminologji, ku është vështirë të vendoset kufiri ndërmjet vetë normës dhe jo normës*.

## 4. Sinonimia dhe dysorët terminologjike

Si element i sistemit terminologjik të një fushe të caktuar termi është i njëkuptimshëm. Njëkuptimësia e termit në rrethin e sistemit ku bën pjesë lidhet me vendin dhe rolin e termave, që zëvendësojnë njëri-tjetrin në aktin e aktualizimit të tyre në tekstet shkencore-teknike dhe në të folur, pra, në përgjithësi në procesin e ligjëritimit. Zëvendësimi i mjeteve gjuhësore të shprehjes njëri me tjetrin, pa ndryshuar konceptin që shënohet prej tyre, është i afërt me dukurinë e sinonimisë leksikore. Disa gjuhëtarë shohin në këtë proces shfaqjen e sinonimisë në terminologji [Duro 2018:41]. Nga pikëpamja e sinonimisë së gjuhës këta terma, që zëvendësojnë ose që mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin, konsiderohen si fjalë, të cilat lidhen në bazë të një kuptimi të njëjtë, p.sh. *koledok - boshti motorik - bosht me bërryla, tension – sforcim – ndemje, shtypje – trysni – presion* etj.

Gjatë studimit të këtyre dukurive është e rëndësishme të përcaktojmë, nëse kemi të bëjmë në terminologji me sinonim apo me dysorë. Në qoftë se dysorët do të konsiderohen sinonime, siç kuptohet zakonisht, atëherë edhe termat, që shënojnë të njëjtin koncept a objekt teknik, do të ishin sinonime. A do të sillte kjo përzierje pëstjellim në kuptimin e dukurive terminologjike?

## 5. Shkaqet e shfaqjes së dysorëve terminologjike

Lindja e dysorëve leksikorë në gjuhën e përgjithshme është një dukuri relativisht e rrahur. Si formime të nivelit të fjalës dysorët leksikorë në gjuhë kanë karakter gjuhësor, kurse dysorët terminologjike, si formime të nivelit të konceptit, kanë karakter logjiko-gjuhësorë. Kjo duhet kuptuar kështu: meqenëse termi shpreh konceptin, kurse koncepti paraqitet edhe në forma gjuhësore të shtjelluara, atëherë dysorët terminologjike janë edhe fjalë edhe togfjalësha. Nga kjo pikëpamje dysorët terminologjike janë formime terminologjike, të cilat në përbërje të çiftit a të vargut shprehin të njëjtin koncept. Si shembuj dysorësh terminologjike mund të sjellim emërtimet terminologjike, të cilat në përbërje të vargut/çiftit, mund të jenë si terma njëfjalësh, ashtu edhe terma togfjalësh: *bosht me gunga-bosht shpërndarës; saldatricë-makinë saldimi*.

## 6. Dysorët terminologjike në rrafshin e shtjellimit dhe të kompaktësimit të mjeteve të shprehjes

Në gjuhën e shkencës dhe të teknikës takohen dysorë terminologjike, njëri nga të cilët është term njëfjalësh i huaj, kurse i dyti term togfjalësh, i përbërë nga mjetet leksikore e fjalëformuese të gjuhës shqipe, si p.sh.: *divizor – kokë ndarëse, fonderi – repart shkrirjeje, saldatricë – makinë salduese, torneri – repart tornosh, trapano – makinë shpuese* etj. Ndërtimet terminologjike të huaja, krahas formimeve shqipe, lidhen në mënyrë të dyfishtë si me vetë objektin teknik, ashtu edhe me ndonjë nga tiparet e tij, të sintetizuara në mjetet e huaja të shprehjes. Kështu, p.sh., *divizor, fonderi, saldatricë, torneri, trapano*, janë secila të barabarta semantikisht me objektet që shënojnë – “*repart*”, “*kokë*”, si edhe me një nga tiparet, që zbulohet te secila shenjë.

## 7. Dysorët terminologjike në rrafshin e kontakteve ndër-gjuhësore

Siç dihet gjuha e shkencës dhe e teknikës është një nga nënsistemet e gjuhës së përgjithshme letrare, e cila ndodhet në këto kontakte ushtrojnë literatura e huaj e në mënyrë të veçantë përkthimi i librave shkencorë-teknik dhe hartimi i teksteve mësimore, në të cilat ballafaqohen strukturat e huaj me ato të gjuhës amtare. Në këtë proces vihen re dy dukuri të kundërta njëra me tjetrën. Nga njëra anë, ndodh që disa autorë tekstesh mësimore ose përkthyes nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur njohjes së thellë të mjeteve fjalëformuese të gjuhës shqipe ose nuk bëjnë përpjekjet e duhura, edhe kur i njohin ato, për t’u shfrytëzuar, në mënyrë që të mos huazojnë pa nevojë fjalët e huaja.

Si rezultat takohen nëpër tekste të veçanta mësimore e doracakë teknikë një varg termash të huaj me një varg termash të huaj me një ndërtim të tejdukshëm fjalëformues, si: *altimetër, densimetër, ekuivalencë, koaksial* etj. Nga ana tjetër përdoren në tekste të tjera dhe futen nëpër fjalorë të ndryshëm terminologjike gjegjëset e tyre shqipe, të cilat ndërtohen duke huazuar strukturat fjalëformuese të termave të huaj dhe duke krijuar kështu kalke, si: *lartësimatës (altimetër), dendësimatës (densimetër), barasvlerësi (ekuivalencë), bashkëboshtor (koaksial)* etj.

## 8. Dysorët terminologjikë në caqet e fjalëformimit të gjuhës shqipe

Dysorët mund të krijohen edhe brendapërbrenda hallkave dysorë të termave shqip. Një pjesë prej tyre paraqiten si dysorë të nivelit të fjalëformimit, kurse më rrallë si variante fonetike. Një grup të veçantë përbëjnë edhe dysorët e nivelit leksikor. Si dysorë të nivelit fjalëformues mund të sjellim: *lakesë-lakorësi, e mesme (aritmetike)-mesatare (aritmetike), i skajshëm-skajor* etj. Krijimi i këtyre çifteve dysorë cenon saktësinë e gjuhës tekniko-shkencore, e ngarkon atë dhe krijon pështjellime në të, prandaj formimi i tyre duhet mënjeluar.

Por, sigurisht, ky mënjanim lidhet me cilësinë e termit, i cili duhet zëvendësuar. Për këtë arsye duhet shqyrtuar vlera e termit të parë nga të gjitha pikëpamjet para se të futet në përdorim. Si dysorë që paraqiten si variante fonetike ose morfologjike, mund të sjellim: *prerje-premje, shtangëri-shtangësi, filetë-fileto, kushinetë-kushineto* etj. Duhet nënvizuar në mënyrë të veçantë, se prania e këtyre dysorëve në gjuhën e shkencës dhe teknikës është një nga dukuritë më negative të terminologjisë. Bashkekzistenca e tyre brenda një teksti shkakton në shumë raste pështjellim dhe cenon saktësinë e informacionit, prandaj këta dysorë duhet mënjeluar.

## 9. Dysorët terminologjikë në rrafshin e terminologjizimit

Gjuha shqipe i plotëson nevojat e komunikimit me fjalë të reja jo vetëm me anën e mjeteve fjalëformuese, por edhe me mjete leksikore, d.m.th., me vetë fjalët ekzistuese, të cilat, duke u rikuptimësuar përdoren si "*fjalë të reja*". Në këtë rast, çdo kuptim i ri i fjalës paraqitet si "*fjalë e re*". Duke u ngritur në term fjala e zakonshme fiton një përmbajtje të re, por që lidhet me fjalën ekzistuese me kuptimin ose kuptimet e saj. Kështu, fjalët ekzistuese të gjuhës amtare të ngritura në terma krijojnë çifte dysorësh me termat e huaj, si: *çast-moment, denduri-frekuencë, dorak-manivelë, dytësorë-sekondar, kah-sens, lakore-kurbë, rikumbim-rezonancë, trysni-presion, veshtulli-viskozitet* etj.

Duke shënuar në mënyrë të njëkuptimshme objektin, dukurinë a konceptin, një nga dysorët e çiftit mund të nxirret përfundimisht nga përdorimi dhe mund të lihet kështu njëri prej tyre për emërtimin e përhershëm të konceptit. Kjo është njëra anë e problemit, kurse ana tjetër, më e rëndësishme, lidhet me faktin, se cili prej dysorëve duhet hequr. Vetëkuptohet se ng të gjitha rastet e përmendura më sipër vështirësi më të mëdha për t'u zëvendësuar paraqesin pikërisht dysorët e krijuar mbi bazën e ngritjes në terma të fjalëve të zakonshme. Si njësi leksikore që i përkasin mbarë gjuhës ato nuk janë fjalë të reja në kuptimin e plotë. Një pjesë e tyre janë fjalë të përdorimit të përgjithshëm, të cilave rikuptimësimi u imponohet nga jashtë në bazë të aftësisë (ngjashmërisë) të kuptimit të tyre me konceptin teknik, pas të cilit ato fiksohen. Kuptimet e këtyre fjalëve janë përgjithësisht të qarta për bartësit e gjuhës (si për specialistes, ashtu edhe për jospécialistët).

## 10. Kufijtë e dysorëve terminologjikë

Shkaqet e shfaqjes së dysorëve terminologjikë janë të ndryshme. Si mjete leksikore dysorët paraqiten si varijime të rrafshit të shprehjes brenda një përmbajtje të vetme konceptore. Por një koncept i caktuar mund të shprehet me mjete kompakte ose me mjete të shtjelluara. Në të gjitha rastet koncepti mbetet i vetëm brenda rrafshit të shprehjes, kurse vetë mjetet i vetëm brenda rrafshit të shprehjes, kurse vetë mjetet e shprehjes e pasqyrojnë konceptin të përmbledhur, si të thuash, të kondensuar, ose të zberthyer, siç del e qartë në rastet e mëposhtme: *bosht me gunga-bosht shpërndarës-bosht i komandimit të valvolave-bosht për hapjen dhe mbylljen e valvolave, kokë rrotulluese-kokë e rrotullueshme-kokë që rrotullohet, sharrë diskore-sharrë-disk-sharrë në formë disku* etj.

Caktimi i kufirit të dysorëve terminologjikë mund të shtrihet si çështje e veçantë vetëm për termat togfjalësh. Mjetet e shprehjes për shënimin e të njëjtit koncept mund të jenë të ndryshme. Mjetet e shprehjes për shënimin e të njëjtit koncept mund të jenë të ndryshme.

Por a mund të jenë ato të gjitha dysorë? Zgjidhja e kësaj çështjeje ka të bëjë në radhë të parë me faktin, nëse elementet e çdo vargu janë ose jo terma. Si rregull, duhet arsyetuar se, në qoftë se ato do të konsiderohen terma, atëherë do të pranohen edhe si *dysorë*. Njësitë jodysore të vargjeve do t'i paraqesim si variante të shprehjes së konceptit. Kështu, p.sh., në vargun *makinë larëse-makinë larjeje* dhe *makinë për larje*, mjetet e shprehjes *makinë larjeje* dhe *makinë për larje* nuk janë dysorë, por paraqiten si variante të shprehjes së konceptit. Si një pikëpamje si variant i shprehjes së konceptit mund të konsiderohet edhe njëri nga dysorët togfjalësh, por në ndryshim nga variantet, dysorët janë terma. Po sjellim një varg shembujsh në ballafaqimet e termave njëri me tjetrin, jo vetëm në kundërvënien term i huaj/ shqip, por edhe në atë shqip/shqip.

### **Terma me caqe konceptore të përcaktuara, që shfaqen si *dysorë*,**

por që mbingarkojnë sistemet terminologjike me emërtime që shënojnë të njëjtin koncept, duke krijuar pështjellim në të kuptuarit e përmbajtjes konceptore [Pllana 2017:228]:

*ekuilibër – balancë – baraspeshë*  
*kambio – shpejtësindeerrues*  
*mi – maus – miush*  
*ndemje – sforcim – tension*  
*ndërprerës – interruptor*  
*ndikim – influencë – impakt*  
*prapaveprim – lidhje e kundërt – fidbek*  
*preciz – i saktë – ekzakt – i përpiktë*

### **Terma si dysorë në kuptime të veçanta:**

*denduri<sub>1</sub> – dendësi – densitet*  
*denduri<sub>2</sub> – shpeshtësi – shpeshti – frekuencë*  
*aplikoj<sub>1</sub> (metodën) – zbatoj – implementoj*  
*aplikoj<sub>2</sub> (forcën) – zbatoj – ushtroj*

### **Terma me caqe të papërcaktuara si pseudo dysorë, ndërmjet të cilëve duhen vendosur vijat ndarëse konceptore:**

*ajrim – ventilim – erim*  
*gërryerje – brejtje – erozion – korrozion*  
*model – gjedhe – kampion – mostër*  
*pluskues – notues – galexhant*  
*qëndrueshmëri – qëndresë – stabilitet – rezistencë*  
*shpejtim – përshpejtim – nxitim – akselerim*  
*trysni – shtypje*

### **Terma me kuptime që kalojnë tek njëri tjetri,**

ku fjala shqipe merr mbi vete kuptimet e shënuara nga termat e huaj: *gërryerje* zëvendëson në mënyrë të ndërsjellët *erozion- korrozion* dhe *abrazion*, çka çon në pështjellim të madh në përcaktimin e kufirit të koncepteve të shprehura nga termat e huaj përkatës; po kështu *bosht* për *bosht* dhe *aks* (si vijë imagjinare), *prerje* për *prerje* dhe *seksion*.

## Përfundim

Në kufijtë e gjuhës së shkencës dhe teknikës krijohen dysorë terminologjike, të cilët ngarkojnë literaturën shkencore-teknike me variante të tepërta termash, që nuk sjellin asgjë të re nga pikëpamja e informacionit që bartin, duke penguar kështu ngulitjen e normës terminologjike të njësuar. Nga shembujt e mësipërm del se termat shqip janë shumë të qartë e të saktë dhe me struktura të tejdukshme fjalëformuese, të cilat zbatojnë mirë përmbajtjen e tyre konceptore. Siç shihet, në kufijtë e gjuhës së shkencës dhe teknikës krijohen dysorë terminologjike, të cilët ngarkojnë literaturën shkencore-teknike me variante të tepërta termash, që nuk sjellin asgjë të re nga pikëpamja e informacionit që bartin, duke penguar kështu ngulitjen e normës terminologjike të njësuar.

Nga shembujt e paraqitur në punim del se termat shqip janë shumë të qartë e të saktë dhe me struktura të tejdukshme fjalëformuese, të cilat zbulojnë mirë përmbajtjen e tyre konceptore. Gjatë hartimit të terminologjive teknike, me qëllim që të vendoset një normë e njësuar, synohet për mënjanimin e sinonimeve dhe thyerjen e homonimisë, duke krijuar, sipas rastit, për çdo njësi homonimike një shenjë të re, siç kemi përmendur *sharrë<sub>1</sub>* (*vegël*) dhe *sharrë<sub>2</sub>* (*sharruese = makinë*).

Këto procese janë parësore sidomos gjatë punës për hartimin e teksteve mësimore, hartimin e fjalorëve dygjuhësh etj., ku krijimet e reja rëndojnë terminologjinë me sinonime (dysorë), duke e shndërruar sinoniminë në një dukuri shumë të dëmshme. Siç u nënvizua më sipër, edhe përpjekja për të minimizuar poliseminë (homoniminë) çon në krijimin e termave herë të suksesshëm, herë të pasuksesshëm, të cilët shtojnë ngarkesën shënjore të gjuhës. Megjithatë, sinonimia, ashtu edhe homonimia ndihmojnë për zgjedhjen dhe rivlerësimin e termave ekzistues, për futjen e termave më të mirë, më të përshtatshëm, që i përgjigjen koncepteve përkatëse

## Referencat

- [1]. Duro, A.: “*Studime gjuhësore 2*”, ASA IGJL, Tiranë, 2018.
- [2]. “*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 2. Terminologjia e matematikës*” (shqip - serbokroatisht - rusisht - frëngjisht), Prishtinë, 1969.
- [3]. “*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 8. Terminologjia e mekanikës*” (shqip - serbokroatisht - rusisht - frëngjisht), Prishtinë, 1970.
- [4]. “*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 12. Terminologjia e arkitekturës*” (shqip - serbokroatisht - rusisht - frëngjisht), Prishtinë, 1969.
- [5]. Pasha, H.: “*Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe*”, ASA IGJL, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017.
- [6]. Leka, F.: “*Udhëzues për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore*”, Tiranë, 1983.
- [7]. Shkurtaj, Gj.: “*Kultura e gjuhës*”, shblu, Tiranë, 2006, 15 p.
- [8]. Pllana, G.: “*FORMIMI I TERMINOLOGJIVE TEKNIKE SHQIPE MBI BAZËN E LEKSIKUT TË PËRGJITHSHËM (Procese të krijimit, të pasqyrimin në gjuhë dhe të standardizimit)*”, BOTIMET ALBANOLOGJIKE, Tiranë, 2017.
- [9]. Thomai, J.: “*LIGJËRATA PASUNIVERSITARE (leksikologji, semantikë, leksikologji)*”, Korçë, 2015, f. 24-31.